



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2021:224238

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05795734

CA.nr.3926/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.O të cilin me autorizim e përfaqëson avokati V.Z, kundër të paditurës Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, për anulim të vendimit, kthim në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.1479/21, të datës 31.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 07.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e themeltë ankesa e paditësit J.O dhe ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.1479/21, të datës 31.01.2024 dhe lënda kthehet në gjykatën e shkallës së parë në procedim të serishëm.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor C.nr.1479/21, të datës 31.01.2024, ka vendosur më sa vijon: I. Hedhet poshtë si e pa lejuar padia me numër C.nr. 1479/21, e datës 05.10.2021, e paditësit J.O, kundër të paditurës Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, me objekt kontesti anulim i vendimit, kthim në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës, sepse e njëjta nuk është paraqitur brenda afatit të paraparë ligjor. II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqituri i autorizuari i paditësit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë në tërësi ankesën e paditësit, aktvendimin e atakuar ta anulojë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), ka gjetur se:

-Ankesa e të autorizuarit të paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, me datën 05.10.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti anulim i vendimit, kthim në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës, me detaje si në padi dhe në procesverbalin e dt.20.11.2023.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar C.nr.1479/21, të datës 31.01.2024, e ka hedhur poshtë si të pa lejueshme padinë e paditësit, duke arsyetuar se: nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se paditësi vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka pranuar me datë 30.06.2021, ndaj të cilit vendim ka paraqitur ankesë tek e paditura edhe pse në shkresa të lëndës nuk është asnjë prove që vërteton datën e dorëzimit të ankesës, por, duke qenë se Komisioni për Ankesa nuk ka hedhur ankesën e paditësit, por të njëjtën e ka trajtuar, gjykata ka konstatuar se i njëjti ka paraqitur ankesë tek e paditura brenda afatit ligjor, mirëpo që nga data e marrjes së vendimit të të paditurës për ndërprerje të punës e deri në marrjen e vendimit të Komisionit për Ankesa, përkatësisht që nga data 30.06.2021 e deri me datë 08.09.2021 kanë kaluar dy (2) muaj e tetë (8) ditë. Në rastin konkret, meqenëse paditësi nuk ka marrë përgjigje në lidhje me ankesën e tij brenda afatit të përcaktuar me nenin 78 par.2 të Ligjit të Punës, i njëjti në afatin vijues prej 30 ditësh do të duhej të paraqiste padi në gjykatën kompetente, ashtu siç parashihet në nenin 79 të Ligjit të Punës, duke mos pritur vendimin e vonuar të të paditurës. Paditësi edhe pse ka pasur mundësi ligjore që brenda afati të përcaktuar ligjor t'i drejtohet gjykatës me padi për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, të njëjtën nuk e ka shfrytëzuar. Meqenëse që nga data e marrjes së vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës (30.06.2021) e deri në datën e paraqitjes së padisë në gjykatë (05.10.2021) kanë kaluar tre (3) muaj e pesë (5) ditë, gjykata erdhi në përfundim se paditësi, nuk mund të ushtrojë padi në gjykatë për mbrojtjen e këtyre të drejtave ngase është tejkaluar afati i përcaktuar me ligj për paraqitje të padisë. Mbi këto arsye gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 79 të Ligjit të Punës, e lidhur me nenin 391 par.1, pika f) të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.1, lidhur me nenin 391.1 pika f) të LPK-së, e lidhur me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Kolegji i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa e të autorizuarit të paditësit është e bazuar, kjo për faktin se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes nuk e ka analizuar me kujdesin e duhur dispozitën e nenit 78 par.2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, e cila dispozitë në mënyrë shprehimore parasheh që: *‘Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës’*. Tutje, sipas nenit 79 të të njëjtit ligj parashihet që: *‘Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente’*. Andaj, duke ju referuar dispozitave të lartcekura dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi J.O, në bazë të vendimit me nr. 372/KBD/21, të datës 24.06.2021, i është ndërprerë marrëdhënia e punës, të cilin vendim paditësi e ka pranuar me datë 30.06.2021.

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka pas të drejtë ankese brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit në Komisionin e Policisë për Ankesa (*këshilla juridike e dhënë në vendim*). Kundër këtij vendimi paditësi ka ushtruar ankesë në Komisionin Për Ankesa të Policisë së Kosovës. Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, me vendimin nr.825-KA-2021, të dt.23.08.2021, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e parashtruar nga ankuesi-paditësi dhe ka lënë në fuqi vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të dt.24.06.2021, të cilin vendim paditësi e ka pranuar me datë 08.09.2021. Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit ka pasur të drejtë të inicioj padi në gjykatën kompetente (*këshilla juridike e dhënë në vendim*). Tutje, paditësi ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë me datë 05.10.2021, çka nënkupton që i njëjti ka respektuar procedurat dhe afatet për ushtrimin e mjeteve juridike të mbrojtjes të parapara me Udhëzimin Administrativ 01/2021 Mbi Marrëdhënien e Punës së Policisë së Kosovës, në bazë të të cilit afatet e përcaktuara janë më të gjata se afatet e përcaktuara në nenin 78 të Ligjit të Punës, çka do të thotë se paditësi padinë e ka ushtruar në gjykatë pas shtjerrës së mjeteve të brendshme dhe atë në afatin vijues prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit të Komisionit të Ankesave, me nr.825-KA-2021, të dt.23.08.2021 dhe brenda afatit të përcaktuar me dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212. Në këtë rast prezumohet se paditësi ka vepruar sipas dispozitave të lartcekur të punës, pasi që punëdhënësi e ka rregulluar me akte të brendshëm procedurën e ankimit brenda institucionit dhe është me i favorshëm se dispozitat ligjore për punëtorët, andaj edhe konsiderohet që padia është e afatshme dhe është në përputhje me dispozitat ligjore, andaj në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të zbatuar dispozitën ligjore të nenit 391.1 pika f) të LPK-së dhe lidhur me këto situata juridike edhe Gjykata Supreme e Kosovës, në aktvendimin e saj REV.nr.382/2022 e datës 22/11/2022, për rastin e njëjtë ka shprehur këtë qëndrim sikur të Gjykatës së Apelit.

Prandaj, shkeljet e tilla të cekura më lartë përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të anulohet.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që me rastin e shqyrtimit të çështjes, udhëzohet të caktojë shqyrtimin përgatitor/kryesor dhe të ftohen palët ndërgjyqëse në mënyrë të rregullt si dhe të vlerësohen të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me qellim që të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Gjykata e Apelit nga të cekurat më lartë, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 194, 208 dhe 209 pika (d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
CA.nr.3926/24, me datë 07.06.2024

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku